



Raport i anketimit për klimën e biznesit dhe investimeve në Kosovë 2021

Rezultatet e sondazhit të 7. të **OEGJK**

ROCK YOUR SPACE



S
O
L
O
S



FURNITURE & LIGHTING

Produktet tona janë të frymëzuara nga kultura të ndryshme internacionale, ku çdo brend ka historinë e vet që tregon për konceptin, modelin dhe lidhjen emocionale. Koleksionet që ne prezentojmë janë të krijuara me materialet më kualitative dhe unike në tregun tonë. SOLOS STUDIO është vendi ku ju mund të zhyteni në botën shumëngjyrshë të mobiljeve me forma dhe stile nga më të ndryshmet.

Adresa: **Veternik, magjistralja Prishtinë – Shkup, km. i 4-të**

Tel.: **+383 49 747 576, +383 49 796 697**

E-mail: **sales@solos.studio**

Web: **www.solos.studio**

Raport i anketimit për klimën e biznesit dhe investimeve në Kosovë 2021

Rezultatet e sondazhit të
Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare

**Situata ekonomike, pritshmëritë dhe
klime të bërit biznes në Kosovë**

Përkrahur nga:

S 
O
L O S

Prishtinë
Qershor 2021

Impressum

© 2021 Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Grumbullimi dhe vlerësimi i të dhënave nga shtetet pjesëmarrëse:

Oda Ekonomike Gjermano-Hungareze

Autore për raportin e Kosovës: Nora Hasani, Drejtoreshë Menaxhuese e OEGJK-së dhe Sytrime Dervisholli, Analiste për Politika dhe Marrëdhënie me Qeverinë në OEGJK

Përmbajtja e këtij raporti mund të shfrytëzohet falas duke deklaruar "Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare në Kosovë" si burim; kërkohet sjellja e një kopje të informatave të përdorura. Informatat mbi raportin janë hartuar me kujdes maksimal. Megjithatë, OEGJK nuk merr asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informatave. OEGJK përjashton të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rrjedhin nga përdorimi i informatave të ofruara.

Kontakt: info@oegjk.org

Tel.: **+383 38 600 880**

Parathënie

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) publikoi anketën e saj të 7-të për klimën e të bërit biznes dhe të investimeve në Kosovë. Ky sondazh përmban vlerësime të kompanive tona anëtare, që janë kryesisht kompani gjermane apo kompani vendore që kanë marrëdhënie tregtare me Gjermaninë si dhe investitorëve të tjerë të huaj mbi situatën ekonomike dhe klimën e investimeve në Kosovë.

Që nga viti 2006, kjo anketë e cila në gjermanisht njihet si AHK Konjunkturumfrage, zhvillohet njëkohësisht në mënyrë të koordinuar nga Dhomat Gjermane të Tregtisë dhe Industrisë në Evropën e Mesme dhe Lindore. Sivjet ekonomitë e 16 shteteve ishin në krahasim. Gjithsej 1454 udhëheqës të kompanive nga këto vende morën pjesë në anketim.

Prandaj anketa vjetore e Odave Ekonomike Gjermane, ofron një bazë të mirë krahasuese ndërmjet ekonomive të shteteve pjesëmarrëse. Përmes saj OEGJK nuk synon të ofrojë një vjetar statistikor, por të vlerësojë faktorët që janë të rëndësishëm për të bërit biznes në Kosovë, dhe të paraqes gjendjen e bizneseve pjesëmarrëse në anketë, në periudhën e anketimit.

Sondazhi është një instrument shumë i mirë për të vlerësuar situatën ekonomike në Kosovë, për të kuptuar kërkesat e kompanive por edhe pritjet që kanë për të bërit biznes me Gjermaninë në të ardhmen, dhe të njejtat t'i marrim parasysh për rekomandimet tona karshi qeverisë.

OEGJK nga rezultatet e sondazhit mëson se ku mund të mbështes ekonominë e Kosovës më tutje, dhe kompanitë anëtare në veçanti. Rezultatet gjithashtu do të jenë në shërbim të qeverisë së Kosovës për të hartuar politika më të mira ekonomike dhe për të ofruar korniza më të mira për lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë.

Sondazhi i Odave Ekonomike Gjermane konsiderohet si barometër i rëndësishëm për të vlerësuar situatën dhe pritjet e kompanive dhe, duke u bazuar në këndvështrimin e tyre, gjithashtu mundëson edhe krahasimin e kushteve për investim ndërmjet këtyre 16 vende. Një vit pas shpërthimit global të koronavirusit që shkaktojë vështirësi të mëdha dhe humbje ekonomike të papara për ekonominë globale dhe atë kosovare, përmes rezultateve të anketës sonë shohim që ka një optimizëm tek bizneset pjesëmarrëse dhe ka pritje pozitive për kohën pas pandemisë.

Për të ndihmuar në kalimin e kësaj situate të vështirë, si dhe për të bërë Kosovën një vend më të mirë për të jetuar dhe për të bërë biznes, OEGJK do të vazhdojë punën intensive në përkrahjen e bizneseve gjermane në Kosovë dhe kompanive anëtare.

Kosovën e pret një perspektivë shumë pozitive për të ardhmen, nëse të gjithë japim kontributin tonë.

Përmbajtja

Parathënie	5
Përmbledhje ekzekutive	7
1. Vlerësimi i zhvillimit ekonomik	9
2. Punësimi dhe investimet	13
3. Vlerësimi i faktorëve të të bërit biznes	14
4. Atraktiviteti i lokacionit	17
5. A do të zgjidhni Kosovën përsëri si një vend për të investuar	18
6. Pandemia COVID-19	18
SHTOJCA	21
A. Pyetjet	21
B. Metodika	24
C. Pjesëmarrësit	24
D. Shkurtesat	25

Përmbledhje ekzekutive

Rreth anketës

- Kompanitë anëtare të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare për të 7 herë me radhë marrin pjesë në anketën e përvjetshme të Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK) në Rajonin e Evropës së Mesme dhe Lindore. Këtë vit 85 udhëheqës të kompanive kosovare u janë përgjigjur pyetjeve tona, megjithëse pjesëmarrësit janë kryesisht kompani gjermane dhe kompani të orientuara nga eksporti.
- Paralelisht me sondazhin kosovar, është kryer një studim i ngjashëm në 15 vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, i cili mundëson krahasime ndërkombëtare të këtyre 16 shteteve.
- Në raport mund të gjeni dhe rezultatet e sondazhit për vitin 2020 në krahasim, megjithëse studimi i vitit të kaluar përfundoi në fillim të Marsit 2020, kur shumica e kompanive nuk mund të parashikonin ende rënien e rëndë ekonomike të shkaktuar nga kriza Covid.

Situata ekonomike dhe pritjet e bizneseve

Pas rënies ekonomike në vitin 2020, shumica e ndërmarrësve të anketuar presin që të ketë zhvillime pozitive këtë vit, për ekonominë në tërësi dhe aq më tepër për kompaninë e tyre. 42% presin një përmirësim të situatës në industrinë e tyre në 12 muajt e ardhshëm, ndërsa 16 përqind presin që situata të përkeqësohet.

Punësimi dhe investimet

Përkundër vështirësive të shkaktuara nga pandemia, shihet që kompanitë pjesëmarrëse në anketim kanë një qasje pozitive dhe janë të gatshëm të marrin riskun dhe të rrisin punësimin dhe investimet në kompanitë e tyre. Për të dy treguesit, rreth 44% e të anketuarve presin një nivel më të lartë të punësimit se në vitin e kaluar, ndërsa 14% kanë plane për të shkurtuar vendet e punës dhe 19% për të ulur investimet.

Kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19

Në periudhën kur është kryer anketimi, 21% e kompanive të anketuara tashmë ishin kthyer në nivelin e shitjeve që kishin para krizës dhe përqindja duhet të rritet në mbi 50 përqind deri në fund të vitit. Në të kundërt, megjithatë, më shumë se 40% e kompanive nuk presin një kthim në nivelin e tyre të mëparshëm të shitjeve deri në vitin e ardhshëm ose edhe më vonë.

Mungesë e punëtorëve të kualifikuar

Udhëheqësit e kompanive të anketuara ankohen për mungesë të fuqisë punëtore, vetëm 6% janë të kënaqur me disponueshmërinë e punëtorëve të kualifikuar, mbi 45% janë të pakënaqur me situatën aktuale. Me shpresën për rimëkëmbjen ekonomike, duhet të investohet më shumë në edukimin profesional.

Kërkohet veprim në drejtim të përmirësimeve nga ana e qeverisë kosovare

Në pyetësor vlerësohen nga të anketuarit 21 faktorë të cilët përcaktojnë cilësinë e vendit si destinacion investimesh, dhe vihet re se për shumë prej tyre ka nevojë për përmirësime. 28% e kompanive janë të kënaqura me sistemin tatimor dhe institucionet tatimore, ndërsa 16% janë të pakënaqur.

Kërkohet luftimi i korrupsionit dhe përmirësimi i sigurisë ligjore

Veçanërisht në fushat e luftës ndaj korrupsionit dhe kriminalitetit kërkohet veprim nga ana e qeverisë së Kosovës. Nga detyrat kryesore dhe më emergjente të qeverisë, përkrah transparencës dhe luftës ndaj korrupsionit, janë përmirësimi i sigurisë ligjore; sistemi tatimor dhe institucionet tatimore; krijimi i kushteve për hulumtim dhe zhvillim; përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësimin profesional dhe disponueshmëria e punonjësve të kualifikuar.

Kosova në krahasim me rajonin e Evropës së Mesme dhe Lindore

Rezultatet e anketimit në Kosovë në krahasim me rajonin paraqesin një qëndrim relativisht të mirë të bizneseve për sa i përket gjendjes dhe zhvillimit ekonomik.

Besnikëria ndaj Kosovës: 79% do të investonin përsëri në Kosovë

Një total 20 vende të Evropës së Mesme dhe Lindore janë vlerësuar në këtë anketë (16 pjesëmarrës + 4 vende të tjera) duke iu përgjigjur pyetjes "Sa tërheqës është vendi si një vend investimi". Përgjigjet janë dhënë në nota nga 1 në 6, ku 1 = shumë tërheqës ... 6 = jo tërheqës. Vlerësimi mesatar i një vendi është mesatarja aritmetike e rezultateve në të 16 vendeve pjesëmarrëse në anketim. Këtu Kosova është renditur e 19ta, me një notë mesatare 4.5. Kjo tregon që duhet të punohet në imazhin e jashtëm të Kosovës. Përkrah se, në vetë-vlerësim, ku kompanitë pjesëmarrëse nga vendi përkatës mund ta vetvlerësonin vendin ku kanë investuar – Kosova është vlerësuar me notën 2.8, dhe 79% e të anketuarve kanë deklaruar që do të investonin dhe sot në Kosovë.

1. Vlerësimi i situatës ekonomike


Pandemia e ka zhytur botën në kohën më të errët, më sfiduese me të cilën jemi ballafaquar ndonjëherë globalisht, por edhe si individë. Në ekonomi ka shkaktuar turbulenca të përmasave aq të mëdha, sa që pritet të lërë pasojë më të thella se ato të “Depresionit të Madh” të viteve të 30-ta. Ashtu si në shumë vende tjera, dhe në Kosovë ekonomia pësoi një rënie të konsiderueshme në vitin 2020, si rezultat i pandemisë. Disa sektorë u prekën më shumë nga masat e parandalimit të pandemisë. Sidoqoftë, efektet negative ndjehen në pothuajse të gjithë sektorët. Nga kjo anketë shohim, se çdo i dyti i anketuar e vlerëson situatën ekonomike si të keqe. Megjithatë, presin zhvillime pozitive në 12 muajtë e ardhshëm. 42% presin një përmirësim të situatës në industrinë e tyre në 12 muajtë e ardhshëm, ndërsa 16 përqind presin që situata të përkeqësohet.

Rezultatet e sondazhit në detaj

1.1 Si e vlerësoni gjendjen aktuale të ekonomisë në shtetin tuaj?

Në anketimin e këtij viti, 51 % e bizneseve të pyetura e vlerësojnë gjendjen ekonomike në Kosovë si “të keqe”; 34 % si “të pandryshueshme” dhe 15% si “të mirë”.


Gjendja aktuale e ekonomisë



1.2 Si e vlerësoni perspektivën e ekonomisë së shtetit tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

Parashikimet për ekonominë e Kosovës në krahasim me vitin e kaluar paraqesin përkeqësim të situatës. 28 % e kompanive të anketuara mendojnë se ekonomia kosovare do të përkeqësohet, 44% mendojnë se situata do të mbetet e pandryshueshme dhe 28 % e tyre presin përmirësime.


Pritshmëritë për situatën ekonomike



1.3 Si e vlerësoni gjendjen aktuale në industrinë tuaj?

Në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni gjendjen aktuale në industrinë tuaj?", rezultatet shënojnë ndryshime negative, duke marrë parasysh efektet e pandemisë COVID-19. Më pak kompani llogarisin një përmirësim të situatës së biznesit të tyre. Në krahasim me vitin e kaluar, 31 % të të pyeturve e gjykojnë situatën e biznesit si më të mirë për vitin 2021, ndërsa 26 % parashikojnë një përkeqësim të situatës financiare të biznesit të tyre.


Gjendja aktuale në industrinë tuaj



1.4 Si do të zhvillohet gjendja në industrinë tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

Në përgjigje të pyetjes “Si do të zhvillohet gjendja në industrinë tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?”, 42% e vlerësojnë situatën si “të mirë”, 41% si “të pandryshueshme” dhe 16% si “të keqe”. Këto rezultate mund t’i atribuohen ndër të tjera edhe efekteve negative të pandemisë COVID-19.


Gjendja në industrinë tuaj në vitin vijues



1.5 Si e vlerësoni gjendjen aktuale ekonomike të ndërmarrjes tuaj?

Në grafikonin poshtë vërehet qartë se bizneset e shohin një situatë të vëshirë sa i përket gjendjes aktuale ekonomike të ndërmarrjeve të tyre.


Gjendja aktuale ekonomike e ndërmarrjes tuaj



1.6 Si do të zhvillohet gjendja ekonomike e ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues, krahasuar me vitin paraprak?

Grafikoni tregon qartë se bizneset kanë pasiguri sa i përket të ardhmes ekonomike të ndërmarrjes së tyre.

Gjendja ekonomike e ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues




2. Punësimi dhe Investimet

Përkundër vështirësive të shkaktuara nga pandemia, shihet që kompanitë pjesëmarrëse në anketim kanë një qasje pozitive dhe janë të gatshëm të marrin riskun dhe të rrisin punësimin dhe investimet në kompanitë e tyre. Për të dy treguesit, rreth 44% e të anketuarve presin një nivel më të lartë të punësimit se në vitin e kaluar, ndërsa 14% kanë plane për të shkurtuar vendet e punës dhe 19% për të ulur investimet.

1.1 Si do të zhvillohet numri i të punësuarve në ndërmarrjen tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

Siç mund të vlerësohet nga grafikoni, 44% e bizneseve planifikojnë që të rrisin numrin e të punësuarve dhe ky është një sinjal pozitiv, që përkundër situatës pandemike, bizneset do të rrisin kapacitetet e burimeve njerëzore.


Numri i të punësuarve në ndërmarrjen tuaj në vitin vijues



1.2 Si do të zhvillohen shpenzimet investive të ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues, krahasuar me vitin paraprak?

Siç mund të shihet nga grafikoni, bizneset shfaqin gatishmëri për të investuar në kompanitë e tyre, përkundër situatës pandemike, më konkretisht 46% e bizneseve janë të gatshme të investojnë.


Shpenzimet investive të ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues




3. Vlerësimi i faktorëve të të bërit biznes

Kompanitë e anketuara rreth kushteve/faktorëve të të bërit biznes në vend janë të mendimit që ashtu si më parë, ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm.


Sistemi tatimor dhe institucionet tatimore




Parashikueshmëria e politikës ekonomike




Luftimi i korrupsionit dhe kriminalitetit




Stabiliteti politik dhe social




Kushtet për hulumtim dhe zhvillim



Cilësia e sistemit të aftësisit profesional



Disponueshmëria e punonjësve të kualifikuar




4. Atraktiviteti i lokacionit

Besnikëria ndaj Kosovës: 79% do të investonin përsëri në Kosovë

Një total 20 vende të Evropës së Mesme dhe Lindore janë vlerësuar në këtë anketë (16 pjesëmarrës + 4 vende të tjera) duke iu përgjigjur pyetjes "Sa tërheqës është vendi si një vend investimi". Përgjigjet janë dhënë në nota nga 1 në 6, ku 1 = shumë tërheqës ... 6 = jo tërheqës. Vlerësimi mesatar i një vendi është mesatarja aritmetike e rezultateve në të 16 vendeve pjesëmarrëse në anketim. Këtu Kosova është renditur e 19ta, me një notë mesatare 4.5. Kjo tregon që duhet të punohet në imazhin e jashtëm të Kosovës. Përshkak se, në vetë-vlerësim, ku kompanitë pjesëmarrëse nga vendi përkatës mund ta vetvlerësonin vendin ku kanë investuar – Kosova është vlerësuar me notën 2.8, dhe 79% e të anketuarve kanë deklaruar që do të investonin dhe sot në Kosovë.

Sa atraktiv janë shtetet në fjalë si vende për t'u investuar?

1 = Shumë atraktiv..... 6 = Aspak atraktiv



Sipas kësaj që po shihet në grafikon, të tjerët Kosovën e vlerësojnë me notën 4.5 ndërsa, ne veten e vlerësojmë me notën përafërsisht 2.8.

Prandaj, si rekomandim del që ka punë për të bërë në përmirësim të imazhit të jashtëm të Kosovës dhe klimës ekonomike.

5. A do të zgjidhni Kosovën përsëri si një vend për të investuar?

79% e të anketuarve do të zgjidhnin Kosovën përsëri si një vend për të investuar, 2% më pak se në vitin 2020. Mesatarja e rezultateve të Evropës së Mesme dhe Lindore në këtë aspekt është 85%.


	SHTETI	2020		2021	
		PO	JO	PO	JO
1	Estonia	-	-	100%	0%
2	Lituania	93%	7%	100%	0%
3	Bullgaria	89%	11%	97%	3%
4	Letonia	79%	21%	96%	4%
5	Polonia	90%	10%	95%	5%
6	Republika Çeke	92%	8%	91%	9%
7	Serbia	81%	19%	90%	10%
8	Hungaria	85%	15%	88%	12%
9	Rumania	86%	14%	86%	14%
10	Slovakia	81%	19%	82%	18%
11	Slllovenia	88%	12%	79%	21%
12	Kosova	81%	19%	79%	21%
13	Bosnja dhe Hercegovina	59%	41%	76%	24%
14	Kroacia	81%	19%	74%	26%
15	Maqedonia e Veriut	64%	36%	68%	32%
16	Shqipëria	67%	33%	65%	35%

6. Pandemia COVID-19

Në periudhën kur është kryer anketimi, 21% e kompanive të anketuara tashmë ishin kthyer në nivelin e shitjeve që kishin para krizës dhe përqindja duhet të rritet në mbi 50 përqind deri në fund të vitit. Në të kundërt, megjithatë, më shumë se 40% e kompanive nuk presin një kthim në nivelin e tyre të mëparshëm të shitjeve deri në vitin e ardhshëm ose edhe më vonë.

Efektet e pandemisë kanë afektuar edhe kompanitë në Kosovë dhe ky raport trajton edhe këtë aspekt ku janë parashtruar disa pyetje për kompanitë, si në vijim:

Kur mendoni se do t'i kthehet ndërmarrjes tuaj qarkullimi i “para pandemisë Corona”?



A e planifikon ndërmarrja e juaj / grupi i ndërmarrjeve tuaja zhvendosjen në kohë të parashikuar nga lokacioni/lokacionet e tanishme?

Nr.	SHTETI	E mundur %	Shumë e mundur %
1	Kosova	43	8
2	Shqipëria	27	2
3	Maqedonia e Veriut	21	6
4	Serbia	19	6
5	Rumania	19	4
6	Slovenia	19	2
7	Bullgaria	19	2
8	Bosnja dhe Hercegovina	17	3
9	Kroacia	15	2
10	Hungaria	14	4
11	Lituania	13	10
12	Republika Çeke	13	3
13	Letonia	13	4
14	Slovakia	10	1
15	Polonia	10	4
16	Estonia	3	3

A e planifikon ndërmarrja e juaj / grupi i ndërmarrjeve tuaja në kohë të parashikuar zëvendësimin apo plotësimin e furnitorëve ekzistues?

Nr.	SHTETI	E mundur %	Shumë e mundur %
1	Letonia	67	8
2	Slovenia	59	9
3	Maqedonia e Veriut	57	6
4	Bosnja dhe Hercegovina	56	13
5	Kosova	55	15
6	Serbia	54	16
7	Lituania	53	23
8	Polonia	53	19
9	Slovakia	50	9
10	Republika Çeke	43	9
11	Estonia	48	3
12	Bullgaria	48	17
13	Rumania	45	9
14	Hungaria	44	15
15	Kroacia	37	9
16	Shqipëria	36	6

SHTOJCA

A. Pyetjet

1.1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale të ekonomisë në shtetin tuaj?

mirë / kënaqshëm / keq

1.2. Si e vlerësoni perspektiven e ekonomisë së Kosovës në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

më mirë / pandryshueshëm / keq

1.3. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në industrinë tuaj?

mirë / kënaqshëm / keq

1.4. Si do të zhvillohet gjendja në industrinë tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

më mirë / pandryshueshëm / keq

1.5. Si e vlerësoni gjendjen aktuale ekonomike të ndërmarrjes tuaj?

mirë / kënaqshëm / keq

1.6. Si do të zhvillohet gjendja ekonomike e ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues, krahasuar me vitin paraprak?

më mirë / pandryshueshëm / keq

1.7. Si do të zhvillohet qarkullimi i ndërmarrjes tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

më shumë / pandryshueshëm / më pak

1.8. Si do të zhvillohet eksporti i ndërmarrjes tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

më shumë / pandryshueshëm / më pak

1.9. Si do zhvillohet numri i të punësuarve në ndërmarrjen tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

më shumë / pandryshueshëm / më pak

1.10. Si do të zhvillohen shpenzimet investive të ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues, krahasuar me vitin paraprak?

më shumë / pandryshueshëm / më pak

2. Me cilën përqindje pritet të rriten kostot e pagave në vitin aktual?

për punonjës, duke marrë parasysh lehtësimin e taksave, në për qind

3. Sa të kënaqur jeni me faktorët e lokacionit?

Shumë i/e kënaqun Shumë i/e pakënaqun
1 2 3 4 5

Anëtarësia në BE

3.1. Administrata publike

3.2. Ngarkesa tatimore

3.3. Sistemi tatimor dhe institucionet
tatimore

3.4. Qasje në subvencione publike

3.5. Infrastruktura (trafiku, komunikimi,
energji)

3.6. Siguria ligjore

3.7. Transparenca e tenderimit publik

3.8. Parashikueshmëria e politikës ekonomike

3.9. Luftimi i korrupsionit dhe kriminalitetit

3.10. Stabiliteti politik dhe social

3.11. Kushtet për hulumtim dhe zhvillim

3.12. Disponueshmëria dhe cilësia e
furnitorëve vendor

3.13. Disiplina e pagesave

3.14. Kostot e punës

3.15. Përkushtimi dhe produktiviteti i
punëmarrësve

3.16. Kualifikimi i punëmarrësve

3.17. Cilësia e kualifikimit akademik

3.18. Cilësia e sistemit të aftësimin profesional

3.19. Fleksibiliteti i ligjit të punës

3.20. Disponueshmëria e punonjësve të
kualifikuar

2. Çfarë ndikimi kanë subvencionet e BE-së për vendimmarrjen rreth investimit tuaj?

janë vendimtare

ndikojnë shumë

ndikojnë pak

nuk janë relevante

përfitojnë nga subvencionet

3. Si e vlerësoni në përgjithësi punën e qeverisë aktuale ?

mirë

kënaqshëm

keq

Pa përgjigje

7.1. A do ta zgjedhnit sërish Kosovën e tanishëm si vend për të investuar?

Po / Jo

7.2. Nëse jo: Cilat janë regjionet e mundshme të zhvendosjes?

Bitte nennen Sie das Land: ...

8. Sa tërheqëse janë këto vende si një vend investimi??

1 = shumë atraktive ... 6 = jo atraktive/ pa përgjigje

AL Shqipëria

BA Bosnja & Hercegovina

BG Bullgaria

CZ Çekia

EE Estonia

HR Kroacia

HU Hungaria

KS Kosova

LT Lituania

LV Letonia

MK Maqedonia e Veriut

PL Polonia

RO Rumania

RS Serbia

SI Sllovenia

SK Sllovakia

UA Ukraina

9. Ku i shihni rreziqet më të mëdha në zhvillimin ekonomik të kompanisë tuaj në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm? (Përgjigje të shumëfishta)

Kërkesa e tregut
Financimi
Kostot e punës
Mungesa e punëtorëve të kualifikuar
Norma e këmbimit
Çmimet e energjisë dhe të lëndës së parë
Siguri ligjore
Kudri i politikave ekonomike
Infrastruktura
Pengesat tregtare / preferencë për kompanitë vendase

10. Kur e mendoni se do t'i kthehet ndërmarrjes tuaj qarkullimi i "para pandemisë Corona"?

tashmë të arritur
në gjysmën e parë të vitit 2021
në gjysmën e dytë të vitit 2021
në vitin 2022
në vitin 2023 ose më vonë
„Ne nuk presim një kthim në nivelet e para- koronës

11. Sa jeni apo keni qenë të kënaqur me masat e qeverisë për zvogëlimin e pasojave të pandemisë Corona në ekonomi?

1 = Shumë i/e kënaqun 6 = Shumë i/e pakënaqun

12. A e planifikon ndërmarrja e juaj / grupi i ndërmarrjeve tuaja zhvendosjen në kohë të parashikuar nga lokacioni/lokacionet e tanishme?

Shumë e mundur / E mundur / e pa mundur / Pa përgjigje

12.B. Nëse po: Cilat janë regjionet e mundshme të zhvendosjes??

Gjermania	Afrika
BE – Europa Perëndimore	Azia
BE – Evropa Qendrore dhe Lindore	Amerika e Veriut
Evropa Lindore (jo-BE)	Amerika Qendrore dhe Jugore

13. A e planifikon ndërmarrja e juaj / grupi i ndërmarrjeve tuaja në kohë të parashikuar zëvendësimin apo plotësimin e furnitorëve ekzistues?

Shumë e mundur / E mundur / e pa mundur / Pa përgjigje

13.B. Nëse po: Cilat janë regjionet e mundshme të zhvendosjes?

Gjermania	Afrika
BE – Europa Perëndimore	Azia
BE – Evropa Qendrore dhe Lindore	Amerika e Veriut
Evropa Lindore (jo-BE)	Amerika Qendrore dhe Jugore

B. Metodika

Mënyra e anketimit:

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare që nga viti 2014 merr pjesë në anketimin e përvjetshëm të Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK) dhe zhvillon një sondazh me anëtarët e saj

Online nëpërmes një platforme të përbashkët të të gjitha 16 shteteve

Përgjigjet janë anonime

Periudha e anketës:

Në vitin 2021, anketimi u zhvillua nga data 15 Mars – 16 Prill 2021

Pyetjet

Pyetjet e parashtruara gjatë anketimit, mund t'i gjeni në shtojcë

C. Pjesëmarrësit

Anketa në Kosovë:

Në anketën e zhvilluar në Kosovë kanë marrë pjesë 85 udhëheqës të kompanive.

Anketa ndërkombëtare:

Përmes Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë që nga viti 2006 zhvillohet anketa vjetore për të vlerësuar klimën e të bërit biznes dhe të investimeve në vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore. Në vitin 2021 anketa u zhvillua në 16 shtete.

Në anketën ndërkombëtare morën pjesë **1.454 udhëheqës të kompanive.**

AL	Shqipëria	48
BA	Bosnja dhe Hercegovina	66
BG	Bullgaria	60
CZ	Çekia	129
EE	Estonia	33
HR	Kroacia	122
HU	Hungaria	206
KS	Kosova	85
LT	Lituania	30
LV	Letonia	24
MK	Maqedonia e Veriut	49
PL	Polonia	241
RO	Rumania	85
RS	Serbia	128
SI	Sllovenia	32
SK	Sllovakia	116
EML	Gjithsej	454

D. SHKURTESAT

Shkurtimet e vendit korrespondojnë me kodin zyrtar të vendit për tregtinë e jashtme të Komisionit Evropian (Rregullore 1833/2006 i 13.12.2006).

NM-11	Vendet e reja anëtare të BE (2004/2007/2013, përjashtuar Maltën dhe Qipro)	HR	Kroacia
		HU	Hungaria
		KS	Kosova
EU-15	Vendet anëtare të BE deri në zgjerim në 2004	LT	Lituania
		LV	Letonia
AL	Shqipëria	MK	Maqedonia e Veriut
BA	Bosnja dhe Hercegovina	PL	Polonia
BG	Bullgaria	RO	Rumania
BY	Bjellorusia	RS	Serbia
CG	Mali i zi	RU	Rusia
CN	Kina	SI	Slllovenia
CZ	Çekia	SK	Slllovakia
EE	Estonia	UA	Ukraina



KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare



Raport i anketimit për klimën e biznesit dhe investimeve në Kosovë 2021

Rezultatet e sondazhit të 7. të **OEGJK**

Tel: +383 38 600 880

Adresa: Rr.Tirana, Icon Tower, kati 9
Prishtinë/Kosovë

www.oegjk.org